



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 891/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Laziç anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohen si të pabazuara ankesat:** Anr.891, Anr.892, Anr.893, Anr.894, Anr.895, Anr.896 Anr.897, Anr.898, Anr.899, Anr.900, Anr.901, Anr.902, Anr.903, Anr.904, Anr.905, Anr.906, Anr.907, Anr.908, Anr.909, Anr.910, Anr.911, Anr.912, Anr.913, Anr.914, Anr.915, Anr.916, Anr.917, Anr.918, Anr.919, Anr.920, Anr.921, Anr.922, Anr.923, Anr.924, Anr.925 të datës 15.11.2013, të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.891, Anr.892, Anr.893, Anr.894, Anr.895, Anr.896 Anr.897, Anr.898, Anr.899, Anr.900, Anr.901, Anr.902, Anr.903, Anr.904, Anr.905, Anr.906, Anr.907, Anr.908, Anr.909, Anr.910, Anr.911, Anr.912, Anr.913, Anr.914, Anr.915, Anr.916, Anr.917, Anr.918, Anr.919, Anr.920, Anr.921, Anr.922, Anr.923, Anr.924, Anr. 925 me datë 15.11.2013, nga subjekti politik AAK dega në Istog, në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur pa rregullsi dhe keqpërdorime të shumta gjatë procesit të votimit nëpër qendrat e vendvotimit QV në Istog.

Parashtruesi i ankesave ka theksuar se janë shkelur dispozitat e LZP-së, Rregullave Zgjedhore, prandaj ka propozuar që të rinumërohen votat dhe të hetohet materiali senzitiv zgjedhor në shumë qendra të votimit QV.

- Në ankesën Anr.891/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në Qendrën e Votimit QV 0601R në Istog është bërë pa rregullsi gjatë procesit të votimit, prandaj me këtë veprim është shkelur neni 15.4, 15.7, 57.1, 57.2 i LZP-së, ku e kundërshtoj rezultatin dhe kërkoj rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Bekë Zekaj në cilësi të komisionerit ku theksohet se, në QV në Istog dyshoj se ka pas manipulime të votave, pasi që mbi 60 votues kanë qenë me mbikëqyrje të asistencës .

- Në ankesën Anr.892/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në vendvotimin VV nr. 4 janë bërë pa rregullsi, ku me këto veprime është shkelur neni 16 i Rregullave Zgjedhore nr. 69/2013 dhe nenet 15.4, 15.7, 57, 57.1, 57.2 i LZP-së, prandaj propozoj që në bazë të nenit 117.4 të rinumërohen votat nga PZAP-i në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Nadir Osmanaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në vendvotimin nr.4 në Sarandran, kamë vërejtur votimin me asistenc të afro 20 personave dhe njerëz që kanë votuar me leje njoftimi të UNMIK-ut me afat të kaluar, ndërsa gjatë numërimit qdo gjë ka qenë në rregull.
- Në ankesën Anr.893/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se janë plotësuar të gjitha kushtet për dyshim ndaj pa rregullsive gjatë procesit të votimit, bazuar në nenin 117.4 të LZP-së, prandaj kërkoj rinumërimin e votave në QV nr.1. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Zenun Haziraj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në ditën kurr është pranuar materiali për votim ne jemi trajnuar që votuesit që janë me dokumente valide të votojnë, por jo me afat te skaduar ashtu siq ka ndodhur nga votuesit potencial. Më tutje thekson se, gjatë kohës së votimit është ndalur rryma dhe në vendvotim ku isha unë si kryesues kanë ardhur shumë votues me asistenc, pra gjatë kohës së numërimit të votave jamë detyruar herë pas herë që t'ia tërhjeku vërejtjen vëzhguesve pasi që mungonte diciplina.
- Në ankesën Anr.894/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 0601C/10R ka bazë të mjaftueshme për rinumërimin e votave, pasi që është shkelur neni 15.4, 16, 117, 117.4 i LZP-së. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Ali Ademaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në klasën ku kamë qenë, kamë vërejtur se ka pas votime me asistenc, përkatësisht nga komuniteti Romë, të cilët janë bartur nga simpatizantët e LDK-së dhe po ashtu dyshoj se nga personat që kanë votuar e kanë paraqitur dokumentacionin falls.
- Në ankesën Anr.895 të datës 15. 11.2013, pretendohet se në në QV 0604C, ka pasur shkelje të nenit 15, 15.4 dhe 15.7 të LZP-së, prandaj lusim PZAP-in që të ketë rinumërim të votave dhe të hetohet materiali zgjedhorë. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Besnik Kabashi në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në vendvotimin VV 0604C në Gurakovc, ka pasur votues me asistenc që për mua janë persona të njohur nga partia e LDK-së.
- Në ankesën Anr.896/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se ka pasur shkelje të nenit 16 pika a,b,c,d dhe f dhe nenit 15, 15.4, 15.7 të LZP-së, prandaj lusim PZAP-in që të ketë rinumërim në qendrën tonë të votimit. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Blerim Demaj në cilësinë e kryesuesit ku theksohet se, ka pas shumë persona që kanë votuar me asistenc dhe më shumë se 15 votues kanë votuar me dokumenta të skaduar.
- Në ankesën Anr.897/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në VV është ndalur rryma, prandaj janë pjekur kushtet për rinumërimin e votave, pasi që

konsiderojmë se është shkelur neni 15, 15.4, 15.7 i LZP-së. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Halil Mirahaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në VV nr.3 në Banjë, kamë vërejtur shumë pa rregullsi, siq ishte ndërprerja e rrymës, asistimi i personave nga radhët e LDK-së në VV dhe dokumentacioni i skaduar i votuesve.

- Në ankesën Anr. 898/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në VV nr. 0601C janë bërë shkelje flagrante dhe kërkojmë nga PZAP-i rinumërimin e votave dhe hetimin e materialit zgjedhor.Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Shemsedin Hamzaj në cilësinë e vëzhguesit ku theksohet se, që nga hapja e VV 0601C/03R ka pasur pa rregullsi, pasi që komisioneri nga radhët e LDK-së ka tentuar me qdo kusht të lejoj të votojë personin nga komuniteti sërb me mbiemërin Bogiç me dokumentin e skaduar të Sërbisë, prandaj me përgjegjësi të plot deklaroj se ka pasë mundësi të keqpërdorimit.
- Në ankesën Anr.899/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se është shkelur neni 15.4, 15.7 i LZP-së, prndaj kërkojmë nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi i votave në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Sefadin Demaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në Dobrush kamë vërejtur se ka pasë më shumë se 50 persona me asistenc.
- Në ankesën Anr.900/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 0606C/060, strukturat e LDK-së kanë bërë blerjen e votës dhe kjo do të konstatohet në këtë kuti ku 1009 votuesë janë të kandidatit nga radhët e LDK-së, prandaj me këtë veprim është shkelur neni 15, 15.4 dh 15.7 i LZP-së. Propozojmë që PZAP-i të i hapë kutitë dhe të rinumërohen votat. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Ylber Lipa në cilësi të kryesuesit ku theksohet se, në QV 0606C/06D ka pasur votues me shoqërues afër 70 persona dhe nga njohja e njerëve shumica e shoqëruesve janë nga radhët e LDK-së, por edhe votuesit me kusht kanë qenë të LDK-së.
- Në ankesën Anr.901/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV janë bërë shkelje të mjaftueshme ku është shkelur neni 11, 11.4 nga polici Izet Demaj, po ashtut neni 15, 15.4, 15.7, 16, 57, 57.1, 57.2i LZP-së, prandaj kërkojmë nga PZAP-i në bazë të ligjit të bëjë rinumërimin e votave në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Imer Mehmetaj në cilësinë e komisionerit rezervë ku ka theksuar se, në QV ka pasur pa rregullsi, pasi që polici Izet Demaj i njësis ROSU, i njëjti me ndikim nga radhët e LDK-së, ka ardhur në QV me makinë zyrtare dhe Haki Zeqiraj në detyrë, në cilësinë e koordinatorit të vëzhguesve nga radhët e LDK-së i ka dhënë kordinata policisë.
- Në ankesën Anr.902/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 0604C/02R, konsideroj se ka pasur votim familjar dhe me këtë veprim janë bërë shkelje të mjaftueshme për mos njohjen e rezultateve zgjedhore, prandaj kërkojmë rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Zeqir Kabashi në cilësinë e komisionerit ku ka theksuar se, në

Gurrakovc në QV 0604c/02R, ka pasur votues me asistenc familjare, pasi që këta persona që asistonin votuesit ishin kryesisht nga radhët e LDK-së.

- Në ankesën Anr.903/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se është bërë shkelje flagrante e nenit 16 të Rregullës Zgjedhore nr.09/2013. Pra kërkojmë nga PZAP-i që në bazë të nenit 117.4 të i rinumëroi votat në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Xhafer Kajtazaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në fshatin Osejan, në VV kamë vërejtur shumë votues që kanë votuar me dokumenta të Sërbisë, ku pas reagimit timë dhe komisionerit nga radhët e LVV-së prap janë lejuar që të votojnë, prandaj dyshoj se është votuar në mënyrë të kundërligjshme.
- Në ankesën Anr.904/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në Istog, në QV nr.7 është bërë shkelje e LZP-së dhe Rregullave Zgjedhore, prandaj e kundërshtojmë rezultatin dhe kërkojmë rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Zeqir Hasanaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në Istog, në VV nr.7 i kamë vërejtur disa pa rregullsi, si votimi i shoqëruar në disa raste që për mua ka qenë e pa drejtë, votimi nga votuesi me leje njoftimi të skaduar të UNMIK-ut.
- Në ankesën Anr.905/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se, në QV 06016/04R është votuar në mënyrë familjare, duke i shkelur nenet 3.8, 6.4, 15, 15.4, 15.7 të LZP-së, prandaj e kundërshtojmë rezultatin zgjedhor dhe kërkojmë nga PZAP-i rinumërimin në QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.09.11.2013 nga Sali Jahaj në cilësinë e kryesuesit ku theksohet se, në fshatin Muzhetin, në VV 0601C/04R gjatë votimit ka pasur votues familjar dhe me asistenc.
- Në ankesën Anr.906/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se është bërë shkelje e neneve 3.8, 15.4, 15.7, 57, 57.1, 57.2 të LZP-së prandaj nga veprimet e kryera e kundërshtojmë rezultatin dhe kërkojmë nga PZAP-i rinumërimin e votave në QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat nga Hamzë Feraj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në shkollën fillore dy perona të pa autorizuar në korridoret e shkollës, për këtë rast është njoftu menaxheri i QV dhe nga të njëjtit persona është kërkuar që të largohen .
- Në ankesën Anr.907/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se janë shkelur nenet 6.4, 3.8, 15.4, 15.7, 16 të LZP-së, konsiderojmë se janë të mjaftueshme që të kundërshtojmë rezultatin zgjedhorë, prandaj lusim PZAP-in që ta urdhëroj KQZ-në për rinumërimin e votave në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklarat të dt.10.11.2013 nga Qaush Mavraj në cilësinë e komisionarit ku theksohet se, në VV 0619C gjatë ditës së votimit shumë persona kanë votuar me asistenc, ku vëzhguesit e LDK-së kanë qenë prezent duke bërë fushat në QV dhe një numër i madhë i personave kanë votuar me leje njoftim të UNMIK-ut.

- Në ankesën Anr.908/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se janë të mjaftueshme kushtet për ta kundërshtuar rezultatin zgjedhor, pasi që janë shkelur nenet 3.8, 15.4, 15.7 të Rregullës Zgjedhore nr.09/2013 dhe nenit 57.1, 57.2 të LZP-së, prandaj kërkojmë nga PZAP-i të vendos rinumërimin e votave në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt. 09.11.2013 nga Demokrat Haliti në cilësinë e komisionerit ku theksohet se me datë 03.11.2013, në Gullakoc, në QV në dhomën nr.06, gjatë votimit kamë vërejtur lëvizje të mëdha të aktivistëve të LDK-së, ku në shumë raste kanë përcjellë votuesit, pra gjatë numërimit procesi ka shkuar në mënyrë të rregullt.
- Në ankesën Anr.909/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV janë të plotësuar të gjitha kushtet që ta kundërshtojmë rezultatin e zgjedhjeve, pasi që është shkelur neni 3.8, 15.4, 15.7, 16 i LZP-së, prandaj kërkojmë nga PZAP-i që në bazë të nenit 117.4 të vendos për rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.10.11.2013 nga Xhavit Hasani në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në fshatin Cerrcë në Vendvotimin VV nr.3 kanë qenë disa pa rregullsi, pasi që me hapjen e VV është arrestuar udhëheqësi i vëzhguesve Imer Hasanaj, pastaj unë kamë intervenuar dhe i kamë caktuar vëzhguesit nëpër klasa. Gjatë procesit të votimit i kamë parë aktivistët e LDK-së duke votuar me asistencë, kemi pasur probleme gjatë numërimit të votave, ku vëzhguesi i LDK-së e ka lëshuar telefonin dhe ndaj të njëjtëve komisioner kemi intervenuar dhe ia kemi ndalën telefonat.
- Në ankesën Anr.910/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV ka pasur pa rregullsi, pasi që është shkelur neni 57, 57.1, 57.2 i LZP-së, prandaj kërkojmë nga PZAP-i të bëjë rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Besarta Palokaj në cilësinë e komisioneres ku theksohet se, ka pasur një numër të madhë të votuesve me asistencë nga LDK-ja dhe shoqërim nga ana e vëzhguesve të LDK-së, prej oborrit të shkollës e deri te VV.
- Në ankesën Anr.911/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 0619C/01R ka pasur pa rregullsi ku edhe është shkelur neni 6, 6.4 i Rregullës Zgjedhore 09/2013 dhe neni 57, 57.1, 57.2 i LZP-së, prandaj e kundërshtojmë rezultatin zgjedhor dhe kërkojmë hetimin e Librave të Votuesve LV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Argzon Berisha në cilësinë e kryekomisionerit ku theksohet se, në VV 0619C-01R gjatë procesit të votimit me dt.03.11.2013 kamë parë disa vëzhgues të LDK-së në VV, ku disa prej tyre kanë shpërndarë fletushka.
- Në ankesën Anr.912/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 0506C/02R kryesuesi Blerim Bala ka shkelur në mënyrë flagrante dispozitat ligjore të LZP-së, prandaj kërkojmë nga PZAP-i që të hapen materialet senzitive dhe Librat e Votuesve në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Nikollë Mirdita në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në QV 0506C/02R personi Blerim Bala nga radhët e LDK-së është afruar disa herë afër kabinave të votuesve, derisa aty kishte votues dhe i ka apeluar votuesit që t'votojnë LDK-në., ku mbi 30 persona kanë votuar me asistencë .

- Në ankesën Anr.913/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV kemi konstatuar shkelje të nenit 16 të Rregulave Zgjedhore 09/13, prandaj e kundërshtojmë rezultatin zgjedhor dhe lusim PZAP-in që ta bëjë rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Valmir Kukliçi ku theksohet se në QV ka pasur shumë tentime që të votohet me dokumente nga një qytet tjetër dhe ka pasur shumë votime me asistencë që janë bërë nga komisioner të partive tjera.
- Në ankesën Anr.914/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV, kemi konstatuar shkelje të nenit 15, 15.4, 15.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 09/13 e që janë të mjaftueshme të kërkohen nga PZAP-i rinumërimin e votave dhe hetimin e materialit zgjedhor. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Ardian Shatri në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në QV 0609C/01R kanë votuar 31 persona me asistencë dhe me letërnjoftim të UNIK-ut.
- Në ankesën Anr.915/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 0606C/05R kanë votuar 75 persona në presion dhe me asistencë, me këto veprime është shkelur neni 15.4, 15.7 i LZP-së dhe lusim PZAP-in që të hetoj materialin zgjedhorë. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Dukagjin Demaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në QV 0606C/05R qdo gjë ka qenë në rregull dhe të gjithë votuesit me asistencë kanë qenë të evidentuar.
- Në ankesën Anr.916/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV konstatojmë është bërë shkelje e neneve 57, 57.1, 57.2 të Rregullave Zgjedhore nr. 09/13 dhe nenit 16 të LZP-së, prandaj mendoj se janë plotësuar kushtet për ta kundërshtuar rezultatin zgjedhorë dhe lusim PZAP-in të bëjë rinumërimin e votave dhe hetimin e materialit zgjedhorë. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.10.11.2013 nga Ndrecë Malsijaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në VV ka pasur numër të madhë të votuesve në asistencë nga radhët e LDK-së .
- Në ankesën Anr.917/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV 2RD ka pasur shkelje të votimit dhe kërkoj nga PZAP-i rinumërimin në këtë QV. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Daut Blakaj ku theksohet se, në Libërin e Votimit LV kamë vërejtur më tepër nënshkrime dhe pas lajmërimit të kryesuesit nuk ka marrë masa askush, si dhe një i dehur i ka marrë 2 fletëvotime në LV, pra i njëjti ka qenë i zgjedhur nga kryesuesi i LDK-së.
- Në ankesën Anr.918/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se gjatë ditës ka pasur shkelje të Rregullave Zgjedhore dhe LZP-së, prandaj kërkojmë nga PZAP- që të urdhëroi KQZ-në të bëjë rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.10.11.2013 nga Florim Nimanaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, sa i përket procesit të numërimit dhe votimit në QV, nuk kamë pasur vërejtje, por votim me asistencë ka pasur mbi 42 persona dhe lëvizje të madhe të simpatizantëve nga radhët e LDK-së.
- Në ankesën Anr.919/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se me dt.03.11.2013 është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore nr.09/2013 dhe nenit 15.4, 15.7 të LZP-së,

prandaj kërkojmë rinumërimin e votave. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Arben Madanaj në cilësi të komisionerit ka theksuar se nga ana e votuesve të LDK-së ka pasur pa rregullsi të mëdha, ku persona të pa njhur i kanë shoqëruar votuesit deri te dhoma e votimit.

- Në ankesën Anr.920/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV ka pasur votime familjare, në listat e votuesve LV ka pasur emra të personave të vdekur, prandaj kërkojmë nga PZAP-i që të bëjë rinumërimin e votave . Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Taulant Bulsakaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në QV procesi zgjedhor ka shkuar në rregull, me përjashtim të disa vërejtjeve që janë vërejtur nga kryesuesi , në lidhje me LV që figuronin emëra të personave të vdekur, votimim me asistencë .
- Në ankesën Anr.921/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV është bërë shkelje e nenit 15, 15.4, 15.7, të Rregullave Zgjedhore, prandaj kërkojmë nga PZAP-i që ta hetojë materialin zgjedhor. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Bajram Zogaj ku theksohet se, në QV 0621C/01R ka pasur votues me asistencë dhe të gjithë janë shoqëruar nga LDK-ja.
- Në ankesën Anr.922/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se është shkelur neni 3, 3.8 dhe neni 6, 6.4 pika b e Rregullës Zgjedhore nr.09/2013, pasi që është votuar në mënyrë familjare, prandaj kërkojmë rinumërimin e votave për kryetar komune në Istog. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Valon Hetemaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në VV nr.5 kamë vërejtur disa pa rregullsi gjatë kohës së votimit, pasi që është votuar pa dokumente valide, numër i madhë i personave kanë votuar me asistencë, ku është ndërprerë rryma .
- Në ankesën Anr.923/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV ka pasur pa rregullsi gjatë procesit të votimit, ku është shkelur neni 57, 57.1, 57.2 i LZP-së, prandaj e kundërshtojmë rezultatin zgjedhorë dhe kërkojmë nga PZAP-i që të hetohet materiali zgjedhorë. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë nga Vllaznim Dreshaj në cilësinë e anëtarit ku theksohet se, ka pasur votim me asistencë, kryesisht kanë qenë votuesit nga radhët e LDK-së ku kanë votuar në mënyrë familjare.
- Në ankesën Anr.924/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se në QV gjatë procesit të votimit ka pasur shkelje të nenit 15, 15.4, 15.7 të Rregullës Zgjedhore, prandaj kërkojmë rinumërimin e votave në Istog. Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Ahmet Ferati në cilësinë e komisionerit ku theksohet se, në VV nr.1 kanë ardhur shumë persona me votë me asistencë dhe ata votues i takonin radhëve të LDK-së.
- Në ankesën Anr.925/13 të datës 15.11.2013, pretendohet se është shkelur neni 16 pika a, b, c, d, e, f e Rregullës Zgjedhore NR.09/2013. . Parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt.09.11.2013 nga Bajram Hajdinaj në cilësinë e komisionerit ku theksohet se gjatë ditës së votimit ka pasur pa rregullsi, pasi që shumë votues kanë votuar në përcjellje të aktivistëve të LDK-së, shumë persona kanë votuar me dokumente të UNMIK-ut.

Bazuar ne nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

### **Ankesat janë të pa bazuara**

Pretendimet ankimore nga ana e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, ku e njëjta ka bërë pa rregullsi dhe keqpërdorime të shumta gjatë procesit të votimit nëpër QV në Istog, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekurat nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 891/2013 më datën 18.11.2013



**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.